



Photo Credit: UN Women, International Women's Day 2022: Gender Equality Today for a Sustainable Tomorrow

Thirrje për veprim të drejtuar nga të rinjtë e të rejat: për një agjendë të përgjegjshme ndaj perspektivës gjinore në lidhje me klimën dhe mjedisin në Shqipëri

Kjo Thirrje për Veprim shpreh interesin tonë të lartë sa i përket garantimit që politikat dhe programet kombëtare për ndryshimet klimatike dhe mjedisin të trajtojnë kërkesat, nevojat dhe cenueshmëritë e grave dhe të rinjve e të rejave në Shqipëri, si dhe të njohin gatishmërinë tonë për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive mjedisore.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike thekson pabarazitë gjinore: shpeshherë, ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë mjedisore sjellin sfida të mëdha për gratë dhe vajzat, ku përfshihet aksesimi më i kufizuar në burime dhe energji, hendeku më i madh në pagë, zotërimi i pabarabartë i pasurive dhe varfëria më e madhe, duke kufizuar kështu aftësinë e grave për të tejkaluar këto sfida dhe për t'iu rimëkëmbur pas tronditjeve që shkaktojnë ngjarjet klimatike madhore. Aktualisht, ndryshimet klimatike po ndikojnë në mënyrë joproporcionale të rinjtë e të rejat pasi cenohet arsimimi, punësimi dhe kushtet shëndetësore të tyre si pasojë e stresit dhe ankthit të shtuar, duke i shtyrë ata drejt migracionit për shkak të përkeqësimit të mjeteve dhe kushteve të jetesës. Të rinjtë dhe të rejat në mbarë botën kanë dëshmuar se janë drejtues të rëndësishëm të veprimit për klimën dhe janë duke udhëhequr rrugëtimin për të ndaluar ndryshimet klimatike. Ne besojmë se dhe të rinjtë e të rejat në Shqipëri mund të përshpejtojnë realizimin e veprimeve klimatike me rëndësi, nëse fuqizohen në mënyrën e duhur dhe nëse zëri i tyre dëgjohej.

Prandaj, **ne parashtrojmë rekomandimet vijuese**, që u drejtohen institucioneve publike, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare, ku përfshihen: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), këshillat vendore, sektori privat, shoqëria civile, organizatat rinore dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri që luajnë një rol drejtues në fushat e barazisë gjinore, ndryshimeve klimatike dhe të rinjve.

Vendosja e barazisë gjinore në qendër të qeverisjes, analizës dhe përgjigjes ndaj ndryshimeve klimatike:

1. Rritja e mbështetjes ndaj grave rurale në bujqësi, përmirësimi i fuqizimit të tyre ekonomik dhe sigurisë së tyre ekonomike dhe ushqimore, duke integruar në mënyrë sistematike përkatësinë gjinore në strategjitë dhe planet kombëtare. Ndër të tjera, përfshihet shtimi i treguesve gjinorë dhe klimatikë në strategjitë përkatëse, si dhe krijimi dhe përdorimi i kërkimit dhe të dhënave në ndërthurjen e barazisë gjinore dhe ndryshimeve klimatike.
2. Promovimi i integritit të perspektivës gjinore në politikat dhe programet e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, përgatitjes dhe ndryshimeve klimatike, duke rritur disponueshmërinë e kërkimit dhe të dhënave lidhur me mënyrën se si fatkeqësitë i prekin gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme.
3. Trajtimi i stereotipeve gjinore dhe njohja e rolit të burrave dhe djemve në trajtimin e pabarazisë gjinore dhe ndryshimeve klimatike.
4. Rivendosja e rolit të aktorëve të ndryshëm si agentë ndryshimi në fushën klimatike dhe mjedisore, duke përfshirë të rejtat dhe vajzat.
5. Ofrimi i edukimit civil dhe mjedisor për vajzat dhe gratë dhe ndërgjegjësimi i tyre rreth ndryshimeve dhe fatkeqësive klimatike.
6. Përfshirja e integritit të perspektivës gjinore në arsimin formal dhe atë joformal, duke e përfshirë edhe në lëndët që lidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin.
7. Përfshirja e ndryshimeve klimatike si pjesë e agjendës së paqes dhe zhvillimit, duke përfshirë Agjendën “Gratë, Paqja dhe Siguria”, si dhe Agjendën “Të Rinjtë, Paqja dhe Siguria” në Shqipëri.
8. Sigurimi i përfaqësimit të barabartë gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes lidhur me ndryshimet klimatike përmes rritjes së numrit të të rejave në nivelin drejtues dhe vendimmarrjen në fushën e ndryshimeve klimatike dhe mjedisit.
9. Përfshirja e integritit të perspektivës gjinore në edukimin seksual gjithëpërfshirës, duke e përfshirë edhe në lëndët që lidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin.

Promovimi dhe investimi në udhëheqjen nga të rinjtë e të rejtat, për të hartuar zgjidhje për ndryshimet klimatike:

1. Njohja e rolit të të rinjve e të rejave si agentë ndryshimi në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe gjetjen e zgjidhjeve, duke i përfshirë ata në negociatat klimatike dhe duke fuqizuar zërin e tyre në proceset e vendimmarrjes përkatëse.
2. Rritja e njohurive dhe të kuptuarit mbi klimën nga të rinjtë dhe të rejtat sa i përket rolit të tyre të mundshëm në trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive mjedisore përmes formave edukative të përshtatura për ta, dhe komunikimi i efektshëm me të rinjtë e të rejtat nëpërmjet përshtatjes së gjuhës ndaj kësaj grupmoshe, me qëllim rritjen e angazhimit të tyre.
3. Ngritja e grupeve këshillimore të larmishme të të rinjve dhe të rejave për klimën në nivel qendror dhe vendor, me qëllim përfshirjen e qëndrimeve të nxitura nga komuniteti, ndërthurëse dhe novatore në proceset e vendimmarrjes mbi klimën dhe mjedisin për zgjidhjet mbi klimën dhe krijimin e një shoqërie me emetime neto zero me fokus tek energjitë e rinovueshme, konsumi i reduktuar, shfrytëzimi eficient i burimeve, etj.
4. Promovimi i punësimit të të rinjve e të rejave në inovacion dhe teknologji përmes arsimit dhe formimit jo tradicional lidhur me aftësitë e punës, për të trajtuar krizat klimatike në nivel vendor dhe kombëtar.

5. Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm me të rinjtë e të rejat palë interesi në Shqipëri për të siguruar se të rinjtë dhe të rejat kanë dijeni politike sa u përket angazhimeve kombëtare dhe vendore mbi klimën dhe mjedisin, dhe se roli dhe përfshirja e tyre janë të mirëpërcaktuara.
6. Fuqizimi i aktivizmit me bazë komuniteti, ndërsektorial dhe të drejtuar nga të rinjtë e të rejat mbi klimën dhe mjedisin përmes sigurimit të mbështetjes së konsiderueshme financiare për përmirësimin e shpejtë të aftësisë rimëkëmbëse në komunitetet e vijës së parë, të ekspozuara ndaj ngjarjeve klimatike ekstreme në Shqipëri, veçanërisht për komunitetet që ndodhen në rajonet bregdetare, ato të vendosura pranë trupave ujorë, etj.
7. Zbatimi i programeve të edukimit mjedisor dhe klimatik në kurrikul, për të ndërgjegjësuar rreth zhvillimit të qëndrueshëm, ndryshimeve klimatike dhe mjedisit përmes mënyrave të arsimit joformal.
8. Integrimi i angazhimit të të rinjve e të rejave në strategjitë aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Strategjinë për Ndryshimet Klimatike, si dhe integrimi i perspektivës gjinore në Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë dhe Strategjinë për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
9. Promovimi i punësimit të të rinjve e të rejave në inovacion dhe teknologji përmes arsimit dhe formimit jotradicional lidhur me aftësitë e punës, për të trajtuar krizat klimatike në nivel vendor dhe kombëtar.
10. Identifikimi dhe përkrahja e nevojave të individëve (dhe/ose bizneseve) që operojnë në treg me gjurmë mjedisore të reduktuar.
11. Inkurajimi i njohjes formale dhe subvencionimit të bizneseve të gjelbra dhe ofrimi i një mbështetjeje më të lartë për zhvillim, në mënyrë që të përftojnë avantazh tregu kundrejt konkurrentëve jomiqësorë me mjedisin.

Promovimi i një agjende më të ndërlidhur sa u përket ndryshimeve klimatike dhe mjedisit:

1. Rritja e koordinimit dhe kapaciteteve të institucioneve publike për të përfshirë perspektivën gjinore dhe rinore në përgjigjen ndaj fatkeqësive dhe risqeve klimatike.
2. Trajtimi i cenueshmërive dhe aftësive përballuese të të rinjve, të rejave dhe grave në vlerësimet e riskut të fatkeqësive dhe klimës.
3. Ndërgjegjësimi i të rinjve e të rejave lidhur me mundësitë për angazhim në politikëbërjen për ndryshimet klimatike dhe mjedisin në nivel kombëtar dhe global, si dhe inkurajimi i të rinjve e të rejave në Shqipëri për të ndërmarrë nisma më të mëdha advokacie për trajtimin e ndryshimeve klimatike.
4. Ndërgjegjësim përmes fushatave drejtuar publikut të gjerë lidhur me efektet e ndryshimeve klimatike te gratë, të rejat dhe të rinjtë.
5. Shfrytëzimi i politikave, programeve dhe nismave ndërgjegjësuese për të inkurajuar ndryshimin e sjelljeve konsumatore në përditshmërinë tonë, duke përfshirë nxitjen e riciklimit dhe praktikave më të qëndrueshme; dhe zhvillimi i masave për reduktimin aktual të emetimeve të gazeve serrë, përmes përkrahjes së mënyrave të gjelbra të transportit, si biçikletat apo ndarja e udhëtimit me të tjerë.
6. Përfshirja e palëve të ndryshme të interesit në proceset e vendimmarrjes lidhur me ndryshimet klimatike dhe mjedisin, duke përfshirë përcaktimin e kriterëve për angazhimin e të rinjve e të rejave në qeverisjen lidhur me klimën dhe mjedisin, për shembull, përmes identifikimit të kuotave të përfaqësimit.

7. Ndjekja e një qasjeje shumëpalëshe, ndërsektoriale dhe ndërbreznore ndaj angazhimit të partnerëve në qeverisjen lidhur me klimën dhe mjedisin përmes angazhimit të të rinjve e të rejave, shoqërisë civile, organizatave të grave dhe ndërmarrjeve private për të marrë pjesë në diskutimet dhe debatet publike rreth qasjeve dhe modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm.
8. Angazhimi ndaj integritit të perspektivës gjinore dhe rinore në proceset e vendimmarrjes dhe hartimin e strategjive kombëtare.
9. Rikonfirmimi i angazhimit ndaj zbatimit të plotë dhe efektiv të Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe angazhimeve të tjera ndërqeveritare, sikurse parashikohet në Kuadrin Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030, Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet Klimatike dhe Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 37 të CEDAW-së për përgjigjshmërinë gjinore ndaj politikave, legjislacionit, planeve, programeve, buxheteve dhe veprimtarive lidhur me RRF-në dhe ndryshimet klimatike.

Përmes këtyre tri temave, ne rekomandojmë fuqizimin e politikëbërjes së bazuar në kërkim dhe evidenca për ndërthurjen e çështjeve lidhur me ndryshimet klimatike, barazinë gjinore dhe të rininë. Gjithashtu, ne rekomandojmë përafrimin e të gjithë legjislacionit përkatës me dispozitat ndërkombëtare dhe ato të BE-së për politikatat e përgjigjshme gjinore për reduktimin e riskut të fatkeqësive dhe barazinë gjinore, si dhe politikatat për ndryshimet klimatike dhe ato mjedisore.

Të rinjtë e të rejat do të ndihmojnë me monitorimin e këtyre rekomandimeve përmes strukturave ekzistuese, si Grupi Këshillimor i të Rinjve i OKB-së dhe Delegatët e Rinj të OKB-së, si dhe të gjithë mekanizmat e tjerë ekzistues për angazhimin e të rinjve e të rejave dhe koordinimin në nivel kombëtar dhe vendor.

Kjo Thirrje për Veprim u krijua falë mbështetjes së Zyrës Kombëtare të UN Women Albania, ekipit të Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë dhe Bashkisë së Tiranës. Aktivistët e rinj dhe organizatat e rrejet e të rinjve e të rejave më poshtë udhëhoqën hartimin e rekomandimeve (emrat janë në rend alfabetik):

Andi Mujollari (ECT), Andi Rabiaj (YVNO dhe UNYAG), Ania Sauku (UNAA), Anxhela Bakiasi (USUP), Ayona Bardhi (New Bridges), Doris Vila (YAG, OSBE), Eas Ev Metani (UNOPS), Ergi Bregasi (EDEN), Francesca Muco (YPN), Frenkli Prengaj (REC Albania), Ilvana Dedja (UNYAG), Mersi Shehu (GUXO), Oljam Dervish (Reinforce Sustainability), Sara Zekaj (YPN), Yllka Vokopola (UNOPS)